

RREGULLORE

Për

Vendosjen e Detyrimit të Shërbimit Universal për Tregun e Energjisë Elektrike në Shqipëri

Neni 1

Objekti

Kjo Rregullore ka për qëllim të sigurojë shërbimin universal të furnizimit me energji elektrike. Shërbimi Universal i Furnizimit është një detyrim i shërbimit publik që i vendoset Furnizuesit të Shërbimit Universal, i cili siguron të drejtën e furnizimit me energji elektrike për konsumatorët familjare dhe konsumatorët e vegjël jo familjarë në Republikën e Shqipërisë, me një cilësi të caktuar të furnizimit, me çmime të rregulluara, lehtësisht dhe qartësisht të krahasueshme, transparente dhe jodiskriminuese, me qëllim mbrojtjen e tyre nga rritjet e paarsyetuara të çmimit duke arritur hapjen e plotë të tregut të energjisë elektrike në një mënyrë të pranueshme nga shoqëria.

Neni 2

Kushtet

Të gjitha termet e përdorur në këtë Rregullore kanë kuptimin e përkthyer në Ligjin nr.43/2016 "Për sektorin e Energjisë Elektrike..

Neni 3

Furnizuesi i shërbimit universal

MIRATUAR ME VENDIMIN NR. __, DATE _____ TE BORDIT TE ERE

1. Kompania OSHEE sh.a në pronësi të shtetit caktohet si furnizuesi i shërbimit universal sipas Nenit 83 të Ligjit nr.43/2015 të Sektorit të Energjisë Elektrike për një periudhë 3 vjet.
2. Duke qënë sigurues i shërbimit universal, OSHEE sh.a. është e detyruar të sigurojë shërbimin publik sipas përcaktimeve të kësaj Rregullore dhe VKM Nr 244..... date 30.03. 2016.
3. Në përputhje me detyrimet e Shqipërisë që burojnë nga Traktati i Komunitetit të Energjisë dhe, përcaktimet e nenit 72 të Ligjit 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” jo më vonë se data 31 Dhjetor 2016. OSHEE sh.a duhet të ndajë aktivitetin e Furnizimit nga ai i Shpërndarjes se energjise elektrike.

Neni 4

Detyrimet e shërbimit publik

1. Për të siguruar shërbimin universal, në përputhje me nenet 5 dhe 6 të kësaj Rregullore vendosen detyrimet e mëposhtme të shërbimit publik mbi kompanitë e tregut të energjisë elektrike, si masa mbrojtëse për interesat e përgjithshme publike:
 - a. shitja e rregulluar e energjisë elektrike nga KESH dhe blerja e saj nga OSHEE sipas nenit 5 të kësaj Rregullore);
Sasia e energjisë elektrike përcaktohet në kontratën e rregulluar ndërmjet palëve, që miratohet nga ERE, bazuar në një regjim

MIRATUAR ME VENDIMIN NR. __, DATE _____ TE BORDIT TE ERE racional shfrytëzimi të kapaciteteve gjeneruese dhe nivelit historik mesatar vjetor të prodhimit.

- b. furnizimin e rregulluar me energji elektrike për konsumatorët familjare dhe konsumatorët e vegjël jo familjarë (Neni 6 i kësaj Rregullore).
- c. për sasine e energjise që nuk mund të sigurohet nga KESH sh.a Furnizuesi i Shërbimit Universal ka detyrimin që të sigurojë sasinë e nevojshme të energjisë në tregun e parregulluar

d.. Furnizuesi i Shërbimit Universal duhet t'u ofrojë klientëve të drejtën e kontratave standarde, të përgatitura në bazë të kushteve standarde të furnizimit me energji elektrike, të miratuara nga ERE, në përputhje me nenin 84, të ligjit nr.43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe legjislacionit përkatës për mbrojtjen e klientëve.

- 2. Brenda 30 ditëve pasi është miratuar kjo Rregullore, këto detyrime të shërbimit publik/ shërbimit universal do të jenë pjesë integrale e licensave përkatëse të kompanive në fjalë të energjisë elektrike në përputhje me Nenin 47 të Ligjit nr.43/2015 të Sektorit të Energjisë Elektrike dhe kësaj Rregullore.

Neni 5

Shitja e rregulluar e energjisë elektrike nga KESH dhe blerja nga OSHEE

- 1. Çmimi i energjisë elektrike për sasitë e ofruara nga KESH sh.a për OSHEE sh.a do të jetë i rregulluar në përputhje me përcaktimet e VKM Nr 244..... date 30.03.2016 ERE do të monitorojë vazhdimisht ecurinë e çmimit dhe të informojë Autoritetin e Konkurrencës në Shqipëri (AK) për çdo të dhënë për abuzim në treg.

MIRATUAR ME VENDIMIN NR. __, DATE _____ TE BORDIT TE ERE

2. KESH sh.a duhet ti shesë dhe OSHEE sh.a duhet të blejë të gjithë energjinë elektrike të prodhuar ose kërkuar si shtesë të vëllimeve të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni në tregjet e organizuara të vendosura në Shqipëri deri në datën 31 Dhjetor 2017.
3. Para se të krijohet tregu i organizuar, OSHEE sh.a duhet të blejë energjinë elektrike të kërkuar nga konsumatorët duke tejkaluar vëllimet e përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni nga prodhuesit dhe tregtarët përveç KESH sh.a në mënyrë transparente, jo diskriminuese, të bazuar të tregu dhe të miratuar e monitoruar nga ERE.

Neni 6

Rregullimi i furnizimit me energji elektrike për konsumatorët familjare dhe konsumatorët e vegjël jo familjare

1. Si furnizues i shërbimit universal, OSHEE sh.a është e detyruar të furnizojë klientët familjare dhe klientët e vegjël jo familjare sipas kushteve dhe çmimeve të rregulluara në këtë Rregullore dhe ne metodologjine perkatese te llogaritjes se cmimit per furnizimin universal në të gjithë territorin e Shqipërisë.
2. Furnizuesi i shërbimit universal duhet t'u ofrojë konsumatorëve të cilët kanë të drejtën e shërbimit universal, kontrata standarte të përgatitura në bazë të një kontrate standarte të furnizimit me energji elektrike të miratuar nga ERE në përputhje me Nenin 84 të Ligjit nr. 43/2015, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" dhe legjislacionit përkatës për mbrojtjen e konsumatorëve. Furnizuesi nuk duhet t'u devijojë kontratave standarte (ose Tip) dhe duhet të marrë përsipër të drejtat dhe detyrimet sipas kompetencave të tyre të plota.

MIRATUAR ME VENDIMIN NR. __, DATE _____ TE BORDIT TE ERE

Kontrata e furnizimit me energji elektrike e nënshkruar me konsumatorët familjare dhe konsumatorëve të vegjël jo familjarë mund të përfundojë në rastet e parashikuara qartë në aktet nënligjore dhe/ose në kontratat.

3. Kontratat e përmendura në paragrafin 2 të këtij Neni duhet të përcaktojnë detyrimin e konsumatorit për të paguar për energjinë elektrike të furnizuar në çmime të miratuara nga ERE, sipas metodologjisë së përcaktuar në Nenin 20 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe Nenin 7 të kësaj Rregullore.
4. Kontratat e referuara në paragrafin 2 të këtij Neni, përveç kushteve të veçanta të përcaktuara në Nenin 80 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, duhet të përcaktojnë detyrimet e furnizuesit të shërbimit universal si me poshte:
 - a) të informojë konsumatorët për të drejtat dhe kushtet që të furnizohet sipas shërbimeve universale;
 - b) të informojë konsumatorët për termat dhe kushtet e furnizimit dhe çmimit të energjisë elektrike dhe ti informojë që kanë të drejtën të zgjedhin një furnizues tjetër;
 - c) furnizimin me energji elektrike sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në këtë Rregullore;
 - d) të informojë konsumatorët mbi masat për të kryer detyrimet e papaguara;
 - e) furnizimi i konsumatorëve në nevojë sipas kushteve të përcaktuara në Ligjin për Sektorin e Energjisë Elektrike dhe legjislacionit përkatës në vend;
 - f) të publikojë në faqen e internetit çmimet e furnizimit të miratuara nga ERE.

MIRATUAR ME VENDIMIN NR. __, DATE _____ TE BORDIT TE ERE

5. Për aq kohë sa nuk është përcaktuar nga kjo Rregullore, shërbimet e furnizimit të energjisë elektrike për konsumatorët familjare dhe konsumatorët e vegjël jo familjarë duhet të parashikohen sipas Rregullave të Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike, të miratuar nga ERE sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në Ligjin e Sektorit të Energjisë Elektrike në Shqipëri.
6. Furnizuesi i shërbimit universal duhet të mbajë një regjistër për numrin e konsumatorëve familjare dhe konsumatorëve të vegjël jo familjarë në Shqipëri. Regjistri duhet të përditësohet rregullisht dhe duhet të komunikohet Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe ERE. Ai duhet të publikohet në faqen e internetit të ERE.

Neni 7

Çmimi i rregulluar për furnizimin e konsumatorëve të fundorë nga furnizuesi i shërbimit universal

1. Çmimi i energjisë elektrike i vendosur nga furnizuesi i shërbimit universal për konsumatorët familjare dhe konsumatorët e vegjël jo familjarë caktohet nga ERE në përputhje me Nenin 85 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.
2. Çmimet e rregulluara për të siguruar shërbimin universal të përmendura në paragrafin 1 të këtij Neni duhet të rriten në mënyrë graduale derisa të arrijnë në pasqyrimin e kostos. Deri në datën 31 Dhjetor 2017, duhet të sigurohet pasqyrimi i plotë i kostos.
3. Çmimi i energjisë elektrike me të cilën Furnizuesi Universal shet energjinë elektrike tek kliente që përfitojnë nga ky shërbim, do të përfshijë koston e arsyetuar të furnizimit me energji elektrike, duke përfshirë koston e blerjes

MIRATUAR ME VENDIMIN NR. __, DATE _____ TE BORDIT TE ERE se energjise nga prodhuesi i ngarkuar me detyrimin e sherbimit publik, kostot e blerjes se enrgjise se prodhuar nga burime te rinovueshme sipas parashikimeve te legjislacionit ne fuqi per BRE, kostot e blerjes se energjise ne tregun e parregulluar, si dhe tarifat e sherbimit te rrjetit te transmetimit dhe shperndarjes si dhe koston e furnizimit.

4. ERE duhet të publikojë Metodologjinë për llogaritjen dhe analizimin e çmimeve të rregulluara për konsumatorët fundorë të sherbimit universal të energjisë elektrike.

Neni 8

Pagesa për të siguruar shërbimin publik

1. Deri në datën 31 Dhjetor 2017, OSHEE sh.a duhet të marrë kompensimin për sigurimin e shërbimit universal sipas kësaj Rregullore, nga buxheti i shtetit i alokuar për të siguruar shërbimin universal sipas vendimit të Këshillit të Ministrave bazuar në Nenin 47(8) të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe Nenit 8 të Rregullores mbi Kushtet për Vendosjen e Detyrimeve të Shërbimit Publik në Tregun e Energjisë Elektrike të Shqipërisë.
2. OSHEE sh.a ka të drejtën e kompensimit nga Buxheti i Shtetit deri në atë masë kur mund të provojë që çmimi i rregulluar i furnizimit me energji elektrike është më i ulët se kostot dhe shpenzimet e bëra për blerjen dhe furnizimin me energji elektrike për konsumatorët familjare dhe konsumatorët e vegjël jo familjarë, sipas Nenit 7 të kësaj Rregullore.
3. Ky kompensim duhet të miratohet çdo vit me anë të një vendimi të Këshillit të Ministrave sipas Nenit 47(8) të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe Rregullores për Kushtet e Përgjithshme për të

MIRATUAR ME VENDIMIN NR. __, DATE _____ TE BORDIT TE ERE
Vendosur Detyrimet e Shërbimit Publik në Tregun e Energjisë Elektrike në
Shqipëri, si dhe shqyrtimit vjetor të rregullimit të çmimit nga ERE sipas
Nenit 85 të Ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.

Neni 9

Shfuqizimi i çmimit të rregulluar për konsumatorët fundorë

1. Para datës 31 Dhjetor 2017, ERE do të shqyrtojë mundësinë për të mbajtur çmimin e rregulluar si një masë të nevojshme për të siguruar shërbimin universal për konsumatorët e lidhur në nivelin e tensionit 0.4 KV. Duke siguruar që kushtet e tregut të zhvillohen në atë mënyrë që konsumatorët të cilëve iu është dhënë e drejta për shërbimin universal, mund ta blejnë energjinë elektrike në treg me çmime të arsyeshme të parrregulluara. Rregullimi i çmimit duhet të hiqet me anë të një Vendimi.
2. Asnjë gjë në këtë Rregullore nuk do të ndalojë ERE-n që të vendosë përsëri detyrimin e shërbimit publik për të siguruar shërbim universal me çmime të rregulluara për konsumatorët familjarë dhe konsumatorët e vegjël jo familjarë në të ardhmen, duke provuar që kjo masë është e nevojshme, e përpjesshme dhe e arsyetuar.

Neni 10

Monitorimi dhe mbikëqyrja

1. ERE, duke vepruar brenda kompetencave të saj duhet të sigurojë monitorimin dhe mbikëqyrjen për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

MIRATUAR ME VENDIMIN NR. __, DATE _____ TE BORDIT TE ERE
2. Të licensuarit dhe personat të cilët e shkelin Rregulloren, do të jenë përgjegjës sipas dispozitave të Ligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike në Shqipëri.

Neni 11

Publikimi i informacionit

Informacioni për përcaktimin e OSHEE sh.a si furnizues i besuar për sigurimin e shërbimit universal duhet të publikohet në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe duhet të vihet në dispozicion të publikut në faqen e internetit të OSHEE sh.a dhe qendrës së informacionit të konsumatorëve, në faqen elektronike të qendrës së informacionit të konsumatorëve, të operatorit të sistemit të shpërndarjes dhe në faqen e internetit të ERE.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore duhet të hyjë në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Neni 13

Njoftimi i Entit Rregullator të Energjisë

MIRATUAR ME VENDIMIN NR. __, DATE _____ TE BORDIT TE ERE
ERE duhet të njoftojë Sekretariatën për miratimin e kësaj rregullore dhe duhet ti
dërgojë një kopje të saj. ERE duhet të njoftojë Sekretariatën edhe për ndryshimet e
mëvonshme në këtë rregullore.